

**i** FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:  
Informacion për pacientin

# ATENOLOL

## Tableta të veshura me film – 100 mg (Atenolol)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efektëve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Atenolol dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Atenolol
- Si ta merrni Atenolol
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Atenolol
- Informacion i mëtejshëm

### 1. ÇFARË ËSHTË ATENOLOL DHE PËRSE PËRDORET

Atenololi, një beta – bllokues përzgjedhës, bllokon receptorët beta1 të zemrës, të cilët ndikojnë kryesisht në sistemin kardiovaskular (ulin ritmin e zemrës, ulin kontraksionin kardiak dhe ulin presionin e gjakut); në të sëmuret me angina pectoris ai ul kërkusat e miokardit për oksigjen, ul shpeshtësinë e krizave anginoze, ul nevojat për nitrate, si dhe rrit tolerancën ndaj veprimtarisë fizike. Atenololi ul presionin arterial sistolik e diastolik.

Atenolol indikohet në hipertension arterial (esencial dhe renal, i vetëm ose i kombinuar me bama të tjera); angina pectoris të shkaktuar nga arteroskleroza koronare; aritmi ventrikulare; aritmi ose takikardi supraventrikulare, infarkt akut miokardi.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Atenolol për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Atenolol.

### 2. PËRPARA SE TË MERRNI ATENOLOL

Mos merrni Atenolol në qoftë se:

- jeni alergjik ndaj atenololit dhe beta-bllokuesve në përgjithësi;
- jeni alergjik ndaj ndonjërit prej përbërësve joaktivë të përmendur në fund të këtij fletëudhëzuesi;
- keni shkallë të dytë dhe të tretë të bllokut A-V;
- keni bradikardi sinusale;
- keni insuficiencë kardiake kongjestive të dekompensuar;
- keni shok kardiogjen;
- vuani nga angina Prinzmetal;
- vuani nga sindromi i sinusit të sëmurë;
- keni hipertension;
- vuani nga asma apo histori të sëmundjeve obstruktive të frymëmarrjes;
- jeni sëmurë me feokromocitomë (përveç përdorimit specifik me alfa bllokues);
- keni acidozë metabolike;
- vuani nga sëmundje të rënda të arterieve periferike;
- trajtoheni për infarkt akut të miokardit të shoqëruar me hipotension (< 100 mm Hg);
- vuani nga sindromi Raynaud.

Ndërprerja e menjëhershme e trajtimit me atenolol është e kundërlindikuar në të sëmuret kardiale.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos i merrni tabletat, shkoni dhe flisni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

#### Tregoni kujdes të veçantë me Atenolol

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se:

- jeni alergjik ndaj barnave të tjera, veçanërisht në qoftë se janë në të njëjtën klasë barnash me Atenolol;
- jeni ose keni në plan të ngeleni shtatzënë gjatë kohës që jeni duke përdorur Atenolol;
- jeni duke ushqyer foshnjen me gji ose po planifikoni të ushqeni foshnjen me gji;
- vuani nga angina pectoris (Atenolol nuk duhet ndërprerë menjëherë gjatë trajtimit të angina pectoris; ndërprerja e menjëhershme mund të shkaktojë çrregullime të rënda të ritmit, infarkt miokardi dhe vdekje të menjëhershme);
- vuani nga insuficienca koronare (këshillohet që sikurse edhe për të gjithë beta-bllokuesit, doza të ulet gradualisht);
- vuani nga asma bronkiale dhe sëmundje të tjera të mushkërive (bronkit, emfizemë); beta-bllokuesit kardioselektivë si Atenolol mund të përdoren me shumë kujdes vetëm kur nuk ka alternativë tjetër mjekimi sepse ekziston rreziku i shfaqjes së bronkospazmave akute, sidomos kur përdoren doza të larta;
- keni probleme të përcimit (bllok A – V i shkallës së parë), sepse ai jep efekt deprimues në përcueshmërinë e zemrës;
- vuani nga hipertensioni portal (rrezik i përkeqësimit të funksionit të mëlçisë);
- vuani nga hipertiroidizmi ose nga tirotoksikozia, sepse Atenolol mund t'i maskojë shenjat e hipertiroidizmit dhe simptomat në të sëmuret që dyshohen për tirotoksikozë;
- vuani nga diabeti sepse Atenolol mund t'i maskojë simptomat e hipoglicemisë dhe prandaj duhet përdorur me kujdes;
- vuani nga psoriaza, depresioni apo miastenia gravis;

- vuani nga sëmundje të veshkave ose të mëlçisë; doza fillestare duhet ulur;
- jeni i moshuar;
- jeni alergjikë, sepse Atenolol mund të rrisë ndjeshmërinë ndaj alergjenëve duke shkaktuar një reaksion mbindjeshmërie më të rëndë se zakonisht dhe mund të reduktojë përgjigjen ndaj adrenalinë;
- do t'i nënshtroheni një ndërhyrjeje kirurgjikale dhe po përdorni Atenolol. Beta-bllokuesit duhen ndërprerë 24-48 orë para ndërhyrjes. Është me rëndësi që anestezisti të jetë në dijeni të përdorimit të beta-bllokuesve.

Pacientët që trajtohen për një kohë të gjatë me një beta-bllokues duhet ta ndërpresin trajtimin gradualisht përgjatë 1 ose 2 javëve.

#### Marrja e barnave të tjera

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë se fundmi bama të tjera, edhe ato pa recetë. Përdorimi në të njëjtën kohë i atenololit me kalçibllokues mund të shkaktojë: rritje të rrezikut për bradikardi dhe bllok atrio-ventrikular me diltiazemin; hipotension të rëndë dhe insuficiencë kardiake me nifedipinën; asistoli, hipotension të rëndë dhe insuficiencë kardiake me verapamilin. Përpara se të fillohet trajtimi me atenolol është e nevojshme të kenë kaluar të paktën 48 orë nga ndërprerja e verapamilit apo diltiazemit dhe e anasjellta. Simpatomimetikët mund të shkaktojnë një antagonizim të ndërsjellë dhe për rrjedhojë edhe uljen e efektit të tyre. Efekti hipotensiv antagonizohet edhe nga kortikosteroidët dhe estrogenët.

Nga përdorimi në të njëjtën kohë i atenololit dhe i klonidinës mund të shfaqet bradikardi dhe deprimum i rëndë i zemrës. Nëse këto dy bama administrohen njëkohësisht, terapia me atenolol duhet ndërprerë shumë ditë përpara ndërprerjes graduale të klonidinës. Nëse klonidina zëvendësohet me terapinë me atenolol, administrimi i tij duhet të fillojë disa ditë pas ndërprerjes së klonidinës. Disa antiinflamatorë josteroidë mund ta ulin efektin antihipertensiv të atenololit. Prazosina mund ta rrisë rrezikun për hipotension ortostatik. Ampicilina mund ta ulë efektin antihipertensiv dhe antianginoz të atenololit.

Përdorimi në të njëjtën kohë i atenololit me insulinën mund ta vështirësojë kontrollin e diabetit.

Amiodaroni mund të shkaktojë: bradikardi, bllok atrioventrikular dhe depresion të miokardit kur merret së bashku me beta-bllokues. Kujdes duhet rreguar edhe nga marrja në të njëjtën kohë e antiaritmikëve të klasës së parë. ACE-inhibitorët (frenuesit e enzimës së konversonit të angiotenzinës), alkooli, alfa-bllokuesit, anestezikët e përgjithshëm, bllokuesit e receptorëve të angiotenzinës II, MAO-inhibitorët, fenotiazinat, anksiolitikët dhe hipnotikët, diuretikët dhe nitratet mund të përforcojnë efektin hipotensiv të tij. Glikozidet kardiake rrisin rrezikun për bllok atrioventrikular dhe bradikardi nëse merren njëkohësisht me atenololin. Moksisiiliti mund të shkaktojë hipotension postural të rëndë nëse merret njëkohësisht me atenololin. Fingolimodi rrit rrezikun për bradikardi kur merret njëkohësisht me atenololin. Këto bama mund të ndikohen nga Atenolol ose mund të ndikojnë në mënyrën se si ai vepron, ndaj në përdorimin e njëkohshëm të tyre është nevoja të ulet ose të rritet doza e atenololit. Mjeku ose farmacisti juaj do t'ju këshillojë.

#### Marrja e Atenolol me ushqim dhe pije

Alkooli mund të ndërveprojë me Atenolol duke zmadhuar efektin hipotensiv, ndaj nuk duhet konsumuar gjatë kohës së mjekimit.

#### Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë. Përdorimi i Atenololit duhet të shmanget gjatë shtatzënisë. Mjeku ose farmacisti do të diskutojnë mbi rreziqet dhe përfitimet e marrjes së këtij bari gjatë shtatzënisë.

#### Ushqimi me gji

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri. Atenolol kalon në qumështin e gjirit në përqëndrim të njëjtë ose më të lartë se përqëndrimi plazmatik tek nëna. Duhet shmangur përdorimi i atenololit gjatë ushqyerjes me gji sepse mund të shkaktojë bradikardi dhe efekte të tjera anësore tek foshnja. Mjeku ose farmacisti do të diskutojnë mbi rreziqet dhe përfitimet e marrjes së këtij bari në qoftë se jeni duke ushqyer foshnjen me gji apo keni në plan të bëni këtë.

#### Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Tregohuni të kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit ose përdorimit të makinerive derisa të shihni se si Atenolol ndikon tek ju sepse ai mund të shkaktojë edhe turbullime të të parit dhe mund të ndikojë në afësitë për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri.

**Informacione të rëndësishme për disa nga lëndët ndihmëse të tabletave Atenolol**  
Veshja me film e tabletave Atenolol 100 mg përmban ngjyresin e tipit AZO, Sunset i verdhë FCF (E 110), i cili mund të shkaktojë reaksione alergjike. Po ashtu, ajo përmban lecitinë (soje). Nëse jeni alergjik ndaj kikirikut ose sojës, mos e përdorni këtë bar.

### 3. SI TA MERRNI ATENOLOL

Gjithmonë merreni Atenolol vetëm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e Atenolol janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Këshillojmë që tabletat t'i merrni në të njëjtën orë çdo ditë. Tabletata Atenolol duhet të gëlltiten të plota me një gotë ujë.

Dozimi i Atenolol është si më poshtë:

*në hipertensionin arterial:* 50 - 100 mg në ditë, megjithëse 50 mg zakonisht është e mjaftueshme. Efekti i plotë është i dukshëm brenda 1-2 javëve.  
*në profilaksinë e krizës anginoze:* 50 - 100 mg në ditë si dozë e vetme ose në doza të ndara.  
*në trajtimin e aritmive:* 50 - 100 mg në ditë.  
*në infarkt miokardi:* trajtimi duhet filluar brenda 12 orëve pas fillimit të dhimbjes së

gjoksit. Atenololi duhet të jepet fillimisht si injeksion intravenoz i ndjekur nga doza orale 50 mg – 100 mg në ditë.

#### Të moshuarit

Nëse jeni i moshuar, mjeku juaj mund të vendosë t'ju ulë dozën, veçanërisht nëse keni probleme me veshkat.

#### Në funksion renal të dëmtuar

Në pacientët me funksion renal të dëmtuar kërkohen doza të reduktuara.

#### Fëmijët

Ky medikament nuk përdoret te fëmijët.

Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni të sigurt për mënyrën e përdorimit.

#### Në qoftë se keni marrë më shumë Atenolol

Në qoftë se keni marrë më shumë Atenolol se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

#### Në qoftë se harroni të merrni Atenolol

Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.

#### Në qoftë se ndërprisni trajtimin me Atenolol

Pacientët që trajtohen për një kohë të gjatë me një beta-bllokues duhet ta ndërpresin trajtimin gradualisht përgjatë 1 ose 2 javëve. Ndërprerja e menjëhershme e beta-bllokuesve mund të përkeqësojë anginën dhe mund të shkaktojë vdekje të papritur. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

### 4. EFЕКTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.

**Mos merrni më tabletat Atenolol dhe shkoni menjëherë te mjeku ose në spital nëse vëreni efektet anësore serioze të mëposhtme. Flisni me mjekun tuaj menjëherë në rast të:**

- Reaksioneve alergjike: nëse përjetoni reaksion alergjik, shkoni menjëherë te mjeku. Shenja të reaksionit alergjik mund të jenë gunga në lëkurë (shenja), ose enjte në fytyrë, buzë, gojë, gjuhë apo fyt.
- Ritmit anomal të zemrës, marrje mendsh, lodhjeje apo të fikti. Këto mund të jenë shenja të një blloku kardiak.
- Vështirësisë në frymëmarrje ose kyqeve të enjtura. Këto mund të jenë shenja të insuficiensës kardiake ose të përkeqësimit të insuficiensës kardiake.

#### Efekte anësore të mundshme të tjera:

**Të zakonshme (mund të prekë deri në 1 në 10 njerëz)**

- Mund të ndjeni që t'ju ulet pulsi kur të merrni tabletat. Kjo është normale, por nëse jeni të shqetësuar, ju lutem flisni me mjekun.
- Duar dhe këmbë të ftohta;
- Diarre;
- Të përziera (nauze);
- Ndjenjë lodhjeje ose dhimbje dhe lodhje të muskujve.

#### Jo të zakonshme (mund të prekë deri në 1 në 100 njerëz)

- Gjumë me shqetësimë.

#### Të rralla (mund të prekë deri në 1 në 1,000 njerëz)

- Bllok kardiak (që mund të shkaktojë marrje mendsh, ritëm jo normal të zemrës, lodhje, të fikët);
- Mpirje apo spazma në gishta, e cila pasohet nga ngrohtësi dhe dhimbje të tyre (sëmundja Raynaud);
- Ndryshime të humorit;
- Depresion;
- Mankthe;
- Ndjenjë konfuzioni, ankthi dhe frike;
- Ndryshime në personalitet (psikoza) ose haluçinacione;
- Dhimbje koke;
- Marrje mendsh (sidomos kur ngriheni në këmbë);
- Ndjesi shpimi në duar;
- Pamundësi për ereksion (impotencë);
- Tharje goje;
- Tharje të syve;
- Çrregullime të shikimit;
- Hollim të flokëve;
- Rash në lëkurë;
- Ulje të numrit të pllakëzave në gjak (kjo mund të lehtësojë mavijosjen);
- Shenja të purpura në lëkurë;
- Verdhëz (zverdhje të lëkurës dhe të së bardhës së syrit).

#### Shumë të rralla (mund të prekë deri në 1 në 10,000 njerëz)

- Ndryshime të qelizave apo të përbërësve të tjerë të gjakut. Mjeku mund t'ju kërkojë analiza të gjakut të shpeshta për të kontrolluar nëse tabletat e Atenolol kanë ndikuar në gjak.

#### Të panjohura (nuk mund të përcaktohet frekuenca nga të dhënat e disponuara)

- Sindromi i ngjashëm me Lupus (një sëmundje në të cilën sistemi imunitar prodhon antitrupa që sulmojnë kryesisht lëkurën dhe kyçet).

#### Gjendje që mund të përkeqësohen:

- Nëse keni ndonjë nga gjendjet e mëposhtme, ato mund të përkeqësohen kur të nisni mjekimin tuaj. Kjo ndodh rrallë, duke prekur më pak se 1 në 1,000 njerëz.
- Psoriazë (gjendje e lëkurës);
  - Vështirësi në frymëmarrje ose keni kyçe të enjtura (nëse keni insuficiensë kardiake);
  - Azëm ose probleme me frymëmarrjen;
  - Qarkullim i dobët i gjakut.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

### 5. SI TA RUANI ATENOLOL

Mbajeni larg fëmijëve!

Mos e përdorni Atenolol pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim. Ruajeni nën temperaturën 25°C!

### 6. INFORMACION I MËTEJSHËM

**Çfarë përmbajnë tabletat e veshura me film Atenolol 100 mg**

**Lënda aktive** është atenolol.

Çdo tabletë e veshur me film përmban 100 mg atenolol.

**Lëndët ndihmëse** janë:

Bërthama e tabletës: karbonat magnezi, celulozë mikrokristalore, amidon, laurilsulfat natriumi, stearat magnezi, glikolat natriumi i amidonit, talk, povidon (K-30); Veshja me film: alkool polivinililik, talk, makrogol, dioksid titani, kinolinë e verdhë, Sunset i verdhë FCF (E 110), lecitinë (sojë) dhe oksid hekuri i kuq.

#### Përmbajtja e paketimit

Kuti me 30 tabletat të veshura me film.



Sipas recetës së mjekut.



Përmbajtja.



Forma e tabletës.



Mbajtësi i autorizimit të tregtimit (MAT) dhe prodhuesi:

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Gusht 2023.

